



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e hënë, në datën 24 dhjetor 2018, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Piro</b>	<b>MISHA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Zylyftar</b>	<b>BREGU</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së paraqitur prej 4 (katër) anëtarëve të Autoritetit të Mediave Audiovizive për lirimin nga detyra të Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. **(Vendimi nr. 201, datë 24.12.2018)**
2. Miratimin e projektbuxhetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për vitin 2019. **(Vendimi nr. 202, datë 24.12.2018)**
3. Zgjedhjen e znj. Irida Fështi, në pozicionin Anëtar i Këshillit të Ankesave. **(Vendimi nr. 203, datë 24.12.2018)**
4. Zgjedhjen e z. Erald Kapri, në pozicionin Anëtar i Këshillit të Ankesave. **(Vendimi nr. 204, datë 24.12.2018)**
5. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në të dhënat e licencës dhe rinovimin e licencës së shoqërisë “Radio Jeta” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Jeta”. **(Vendimi nr. 205, datë 24.12.2018)**
6. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Media New Vizion” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio 1” **(Vendimi nr. 206, datë 24.12.2018)**
7. Pajisjen e shoqërisë “F.K.T” sh.p.k., me licencë për shërbimin e programit audioviziv “Tv Apollon” **(Vendimi nr. 207, datë 24.12.2018)**
8. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “TV AVN” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të AMA-s, nr. 169, datë 12.09.2018 “Për konstatimin e pavlefshmërisë së licencës për transmetime analoge të shoqërisë “AVN” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “TV AVN”. **(Vendimi nr. 208, datë 24.12.2018)**

**Tiranë, 24 dhjetor 2018**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**